



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0471

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuesë, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit duke vendosur sipas ankesës së OE “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., si dhe OE “Delta Security” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK PRISHTINË”, më 06/08/2025, me shumicë votash mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., me nr. 2025/0471, e datës 10/06/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KK PRISHTINË”.
2. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE “Delta Security” SH.P.K. me nr. 2025/0484, e datës 13/06/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KK PRISHTINË”.
3. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - “KK PRISHTINË” për aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1. Ndërkaq lënda kthehet në Rivlersim.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., me nr. 2025/0471 aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të

kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

5. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik OE “Delta Security” SH.P.K. me nr. 2025/0484, e datës 13/06/2025 ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25/09/2024, “KK PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1. Ndërsa me datën 21.05.2025 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: Loti 1 Vlera e parashikuar e kontratës është 1,330,000.00 €.

Me 26.05.2025, OE “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., dhe OE “Delta Security” SH.P.K., me datën 26.05.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.06.2025, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., dhe me datën 03.06.2025 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim te OE “Delta Security” SH.P.K.,

Me 10/06/2025, OSHP ka pranuar ankesat nga OE “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., me nr. 2025/0471 dhe ankesën e OE “Delta Security” SH.P.K., me nr.2025/0484 me datën 13/06/2025 lidhur me aktivitetin “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0471/25 dhe ankesa nr. 0484/25 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., për ankesën me nr.2025/0471 janë parashtruar si në vijim:

Si palë me interes konform Nenit 4.1.26 të LPP-së, si palë e pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 21.05.2025, konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar edhe në Nenin 64.1 e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik paraqesim këtë:

ANKES: Të pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 21.05.2025 për rekomandimin për dhënie të kontratës, si dhe vlerësimit të gabuar të ofertave të cilat nuk janë krahasuar dhe ekzaminuar sipas Nenit 59.4 të LPP-së sipas kërkesave të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë, konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar edhe në Nenin 64 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paraqesim këtë "ankesë" ndaj aktivitetit të prokurimit me titull: Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave me nr.prokurimi: 616-24-10100-2-1-1 e inicuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.

Për shkak se: Kuvendi Komunal i Prishtinës

Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar operatorin ekonomik, i cili nuk ka plotësuar kërkesat dhe kriteret e aktivitetit të prokurimit me të dhënat e lartëcekura, si dhe ka eliminuar kompaninë tonë pa të drejtë ku kemi ofertuar vetëm për LOT-1. Autoriteti Kontraktues ka ra në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik duke mos bërë vlerësimin e ofertave sipas kërkesave të vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të tenderit

Më poshtë do të argumentohet përpërgjegjshmëria e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë për LOT-1.

Me datën 21.05.2025 Autoriteti Kontraktues në platformën e E-prokurimit fillimisht kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, të pakënaqur me këtë vendim ne si operator ekonomik paraqesim kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues me datën 26.05.2025, duke dhënë pretendimet tona ankimore të pabazuara.

Provë: Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 21.05.2025.

Pas pranimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së, menjëher kemi kërkuar qasje në dokumentet publike të këtij aktiviteti të prokurimit, qasja na është lejuar konform kërkesës sonë të parashtruar mirëpo qasja ka qenë e kufizuar në dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit pasi që Autoriteti Kontraktues dokumentet e klasifikuara si sekret afarist të markuara nga operatori i

rekomanduar për kontratë nuk na ka lejuar qasje dhe nuk e ka përgatit versionin e pastruar të dokumenteve të klasifikuara si sekret afarist, me çrast ka ra në kundërshtim me dispozitat ligjore Neni 7.6.3 të Rregullores Nr.002/2024 dhe Neni 11 par.4 të LPP-së.

Neni 7.6.3 i Rregullores Nr.002/2024 thotë: Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, dyja palët.

Në bazë të gjendjes faktike, me rastin e vlerësimit të ofertave konform Neni 59 të LPP së dhe Neni 40 të Rregullores Nr.001/2022 të PP-së ne jemi diskriminuar gjatë vlerësimit, pasi që ofertat nuk janë trajtuar njëjtë me vetë faktin se operatori ekonomik i rekomanduar këtë rast është favorizuar dhe nuk mund të quhet trajtim i barabartë sipas Neni 7 të LPP-së, por diskriminim total, dhe jo i drejtë.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka përfillur Nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kursimin e buxhetit të Republikës së Kosovës, por e rekomandon një operator ekonomik më të shtrenjtë se oferta jonë në shumë prej 4,780.08 euro, në muaj apo 71,701.20 euro për 15 muaj.

Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1, pas analizimit të dokumenteve të pranuar nga qasja e lejuar konstatojmë se i njëjti është i papërgjegjshëm për shkak se:

Hapja e ofertave ka qenë me datën 24.02.2025.

Në dosjen e tenderit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të posedoj Frekuencat për sistem radio komunikimi, lëshuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) (valide)

Evidenca 5. Të dëshmohet me licencë nga ARKEP (kopje e noterizuar). Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar

"Autorizimin Individual" me nr.23/02/0137 me periudhë të vlefshmërisë deri me datën 22.02.2025 që i bie se është e skaduar, pasi që data e dorëzimit të ofertave ka qenë 24.02.2025.

32.4 Është përgjegjësi e ofertuesit të ngarkoj të gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin e prokurimit elektronik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Çfarëdo dokumenti që duhet të jetë pjesë e ofertës/aplikacionit, ofertuesi duhet ta ngarkoj dhe dërgoj vetëm nëpërmjet funksionit "dorëzimi i tenderit" dhe jo nëpërmjet ndonjë funksioni tjetër. Koha e ngarkimit mund të dalloj në varësi të shpejtësisë (daljes) së lidhjes së internetit të ofertuesit dhe të ngarkesës së përgjithshme të sistemit. Pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderit sistemi nuk lejon futjen e ndonjë dokumenti shtesë në lidhje me tenderin.

Operatori i rekomanduar për kontratë Listën e Çmimeve (fajllin) shabllonin e ka modifikuar gjë që nuk lejohet një modifikim i tillë dhe është në kundërshtim me Nenin 32.8 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurimin publik ku thuhet:

32.8 Tenderuesit shkarkojnë Formularin e Dorëzimit të Tenderit në kompjuterin e tyre dhe nëse është e aplikueshme e nënshkruajnë atë duke përdorur nënshkrimin(et) e tyre të avancuar digjital. Ofertuesit NUK DUHET të ndryshojnë apo modifikojnë përmbajtjen dhe strukturën e Formularit të Dorëzimit të Tenderit. Është përgjegjësi e ofertuesit për të përdorur certifikata për nënshkrim dixhital që është ligjërish e pranueshme në Kosovë dhe për të përdorur mjetet për zbatimin e nënshkrimeve digjitale në përputhje me standardet teknike të përcaktuara nga Kushtet e përdorimit; Kushtet e përdorimit propozojnë të paktën një mjet të lirë në dispozicion për zbatimin e nënshkrimit të avancuar digjital në Formularin e Dorëzimit të Tenderit.

Sipas Nenit 17.2 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thuhet: Struktura e dosjes së tenderit përbëhet nga tri pjesë: Pjesa A - Procedura e tenderimit Pjesa B - Draft Kontrata Pjesa C - Formulari i Tenderit dhe Neni 17.7 thotë: Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Pjesa C përbëhet nga: - Formulari i tenderit - Lista e çmimeve.

Operatori ekonomik dokumentin e ngarkuar "Lista e Çmimit" ka ndryshuar dhe ndërhyrë duke ngjyrosur disa kolona me ngjyrë pembe, gjë që nuk është e lejuar të modifikohet sepse ligji ka ndaluar ndryshimin apo modifikimin e përmbajtjes.

Poashtu në dosjen e tenderit është kërkuar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 3. d) Licenca dhe Autorizimi për një klient aktiv për Shërbimet e Tubimeve Publike sipas Ligjit Nr.04 L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë (valide)

Evidenca 3. d) Të dëshmohet me licencë dhe autorizim nga MPB (valide) (kopje); Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "Autorizim për fillimin e veprimtarisë" me nr.prot.2834 të datës 26.12.2024 e cila tek pjesa e Arsytimit tregon se fillimi dhe ndërprerja e kontratës me klientin është e skaduar pra deri më 28.12.2024.

Sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Autorizim valid për një klient aktiv!

Poashtu në dosjen e tenderit është kërkuar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të caktoj a)- minimum (1) menaxher të projektit me vendim i cili ka përvojë pune min.3 vite dhe është i certifikuar për menaxhim risku dhe i licencuar nga MPB si menaxher i sigurimit zyrtar në detyrë si për shërbimet themelore dhe të specializuara.

Evidenca 4. a). Dëshmi që Menaxheri i Projektit duhet të ketë të kryer shkollimin e mesëm, të dëshmohet me kopje të diplomës, b. Duhet të dëshmoj se ka përvojë 5 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik, c. Duhet të dëshmoj me Licencën për Menaxher nga MPB-me në fushën e sigurisë fizike sipas Ligjit Nr.04 L-004 për Shërbimet Private të sigurisë.

Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "Dokumentet e menaxherit me emër KRESHNIK IMERAJ" i njëjti është i licencuar vetëm si Menaxher për shërbimet themelore të sigurisë, dhe jo për ato të specializuara siç parashihen sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurisë e të cilat janë Menaxher për Operatorët e Mbikëqyrjes Elektronike, Menaxher për Rojet e Transportit të Parave të Gatshme apo Menaxher i Operatorëve të Mbrojtjes së Afërt e të cilat cilësohen bazë të Ligjit Shërbime të Specializuara. Sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar të jetë i licencuar për dy shërbimet; 1.themelore, 2.specializuara.

Personi në fjalë ka vendosur "Certifikatën nga MPB" për trajnime të specializuara mirëpo për pozitën Menaxher i Sigurimit për Shërbimet Themelore dhe ka tentuar që ta lajthit Autoritetin Kontraktues, mirëpo ju keni kërkuar që Menaxheri të jetë i licencuar dhe jo i certifikuar.

Poashtu në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë është kërkuar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses, kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Për lotin 1, OE duhet të ketë kontrata të përfunduara jo më pak se 1,995,000.00 euro,

Evidenca 1. Lista e kontratave të përfunduara në lëmin e shërbimeve të ngjashme, për tri vitet e fundit, e cila duhet të jete nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke Saktësuar; Titujt e kontratës, shumën e kontratës, datën e nënshkrimit dhe datën e përfundimit – Lista duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, dhe të i bashkëngjis dëshmitë e përfundimit , Referenca , ose procesverbalet e pranimit, kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve, mund të shërbejnë edhe dëshmi tjera të pranimit të shërbimeve, të cilat duhet të dëshmohen me transaksione bankare të plotësohet Aneksi 7 - obligueshme për dy Lotet.

Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "Transaksionet bankare" mirëpo të njëjtat janë të vulosura nga vetë operatori ekonomik dhe jo nga banka, gjë që nuk mund të vërtetohet saktësia e këtyre transaksioneve bankare për shkak se të njëjtat nuk janë të validituara nga bankat komerciale të licencuara nga BQK.

Kompania jonë sipas Njoftimit mbi vendimin e AK-së është eliminuar në arsyetim: Një mospërputhje është vënë re në çmimin e ofruar: në formularin e ofertës është paraqitur shuma prej 1,248,712.98 EUR, ndërsa paramasa është dhënë një çmim tjetër prej 1,246,804.20 EUR, duke krijuar një diferencë prej 1,908.78 EUR. Komisioni ka kërkuar sqarim në lidhje me këtë mospërputhje dhe ka kërkuar informacion se cili është çmimi përfundimtar: ai i formularit apo ai

i paramasës. Me datë 30.04.2025, janë pranuar sqarimet shtesë nga GOE, ku ata kanë konfirmuar se çmimi i paraqitur në formular është korrekt. Pas shqyrtimit të këtyre sqarimeve, komisioni konstaton se GOE nuk ka ofruar dëshmi bindëse që të justifikojnë këtë mospërputhje, e cila është në kundërshtim me nenin 40.10 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr.001/2022, i cili parashikon që në rast të mospërputhjes mes çmimit të formularit dhe përshkrimit të çmimeve, oferta refuzohet.

Arsyetimi i AK-së është i gabuar dhe nuk përkon me realitetin. Kompania jonë ka pranuar përmes platformës së E-prokurimit me datë 29.04.2025 letrën standarde për sqarimin e tenderit, dhe me datën 30.04.2025 kemi kthyer përgjigjen tonë Autoritetit Kontraktues poashtu përmes platformës së E-prokurimit duke ngarkuar dëshmitë e kërkuara.

Provë: Letra standarde për sqarimin e tenderit nga Autoriteti Kontraktues, datë 29.04.2025.

Provë: Përgjigje letrës standarde për sqarimin e tenderit nga Operatori ekonomik, datë 30.04.2025.

Në përgjigjen e dërguar sipas dokumentit të bashkangjitur, aty ku Autoriteti Kontraktues ka cekur në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar se "Me datë 30.04.2025, janë pranuar sqarimet shtesë nga GOE, ku ata kanë konfirmuar se çmimi i paraqitur në formular është korrekt." nuk është e vërtetë dhe është plotësisht e pasaktë, sepse ne kemi shënuar "Sa i përket mospërputhjes së çmimit në formularin e ofertës dhe çmimit të paramasës, ju informojmë se çmimi në paramasë është i saktë dhe se ka ndodhur ndonjë gabim teknik".

Pra ne kemi thënë se çmimi në paramasë është i saktë dhe se ka ndodhur ndonjë gabim teknik, dhe nuk kemi thënë se çmimi i paraqitur në formular është korrekt.

Ju me datën 29.04.2025 keni kërkuar sqarim nga kompania jonë "Keni një mospërputhje në çmimin e ofruar: në formularin e ofertës është dhënë shuma prej 1,248,712.98 EUR, ndërkohë që në paramasa është paraqitur një çmim prej tjetër 1,246,804.20 EUR, duke krijuar një diferencë prej 1,908.78 EUR, që është brenda kufijtë ne marzhën e gabimeve aritmetike prej 2%. Andaj kërkoj një sqarim për këtë çmim dhe të njoftoni AK-në për çmimit përfundimtar a është i formularit apo i paramasës."

Në Listën e Çmimit ju keni kërkuar çmimin mujor (njësi) vlerën totale mujore në EURO, sipas dokumentit me këtë emërtim.

Mospërputhja e çmimit për njësi mujore (siç paraqitet në përshkrimin e çmimit) me çmimin total në formularin e tenderit konsiderohet gabim aritmetik, nëse bëhet fjalë për një llogaritje të pasaktë ndërmjet çmimit për njësi dhe sasisë totale (muajve, në këtë rast).

Autoriteti kontraktues ka të drejtë të korrigjojë gabimet aritmetike në tenderët e paraqitur, përfshirë ato në çmimin për njësi dhe total, për aq kohë sa korrigjimi është në përputhje me çmimin për njësi të ofruar nga operatori ekonomik. Një mospërputhje e tillë është gabim aritmetik, dhe rregullorja e prokurimit në Kosovë lejon që ai të korrigjohet në favor të çmimit për

njësi.

Rregulli i përgjithshëm është: Nëse ka mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, çmimi për njësi konsiderohet i saktë, dhe çmimi total korrigjohet në përputhje me të. Çmimi njësi mbizotëron.

Dispozita ligjore e cekur nga ana e Autoritetit Kontraktues Neni 40.10 pika b. e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik nuk mund të përdoret si arsyetim për ofertën tonë për shkak se kompania jonë Çmimin njësi e ka në rregull dhe pikërisht vlen dispozita e njejtë pika a) për rastin e ofertës sonë ku thuhet: "Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet".

Bazuar në Nenin 40.12 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik e cila përcakton: 40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit", si dhe Neni 45.24 thuhet: Bazuar në nenin 56.3 të LPP, tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe / ose në dosjen e tenderit.

Neni 40.2 i Rregullores Nr.001/2022 të PP-së thotë: Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë.

Neni 40.13 i Rregullores Nr.001/2022 të PP-së thotë: AK do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Citoj dispozitën Neni 40.2. Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim.

Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Sipas Nenit 1 të LPP-së, Qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të

drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Nga po e njëjta dispozitë ligjore thuhet se ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Citoj dispozitën e Nenit 60 të LPP-së: 1. Autoriteti kontraktues do tia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara si dhe dispozitat e nenit 60 të LPP së pretendojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të këtij neni me rastin e marrjes së Vendimit për dhënie të kontratës për OE i cili për nga çmimi është shumë më i lartë, pra AK nuk ka respektuar Kriterin për dhënie të kontratës.

Kompania jonë ka ofertuar më lirë se kompania e rekomanduar për kontratë në shumë prej 4,780.08 EUR, kështu që është dëmtuar buxheti i Republikës së Kosovës.

Andaj konsiderojmë se një kërkesë e tillë e pa cekur është në kundërshtim me Nenin 7.2 të LPP-së ku thuhet: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik".

Neni 7.4 i LPP-së thotë: "Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik".

Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues ti trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe po ashtu të veprojnë në mënyrë transparente, duke larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjor të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "SKYFTERAT – LIVE" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1 - Qëllimi, Neni 7 - Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi, Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës, Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste, Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve, Neni 60 - Kriteret për dhënie të kontratës. Dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik që supozohet të jenë shkelur: Neni 27 - Kriteret e dhënies së kontratës, Neni 40 -

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Me ç ‘rast kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas analizimit të të gjitha pretendimeve tona ankimore në lidhje me shkeljet e supozuara të dispozitave ligjore që janë në fuqi, të nxjerr V E N D I M te APROVOHET si e bazuar ankesa jonë për rishqyrtim në lidhje me aktivitetin e prokurimit dhe ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe lënda lidhur me aktivitetin e prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që as për vet parashtruesin nuk është kontestues fakti që i njëjti ka ofertuar me çmim tjetër në paramasë dhe krejt tjetër çmim në formularin e tenderit. Përmes nenit 40.10 par. b) të RRPP përcaktohet se "Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet".

Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se oferta e dorëzuar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT duke përfshirë edhe licensat dhe autorizimet e kërkuara. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Delta Security” SH.P.K., për ankesën me nr.2025/0484 janë parashtruar si në vijim:

Te pa kënaqur me njoftimin B58 mbi vendimin e AK-së KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES te datës 21.05.2025 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave me nr. te prokurimit: 616-24-10100-2-1-1 ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, e ushtrojmë këtë ankese pranë OSHP-se: Për shkak se AK-KOMUNA E PRISHTINËS : - Ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) te vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje te Tenderit (DT.) - Ne mënyrë te kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate Operatorin Ekonomik te pa përgjegjshëm të cili

nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)

Sqarojmë në mënyrë të detajuar : Autoriteti Kontraktues KOMUNA E PRISHTINËS me datën 21.05.2025 ka bërë publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, në mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.) dhe në mënyrë të kundërligjshme e ka rekomanduar për kontratë Operatorin e pa përgjegjshëm të cili nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.) i mbetet AK-se që të bëjë ekzaminimin krahasimin dhe vlerësimin e ofertave në mënyrë të drejtë dhe pa diskriminim. Vetëm i bëjmë me dije AK-se se OE të rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm dhe nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.) dhe pasi ta kthejë lenden në rivlerësim të përmirësuar gabimet e veta. Se pari po sqarojmë eliminimin e kundërligjshëm nga ana e AK-se:

Me publikimin e B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-se të datës 21.05.2025 gjithashtu bashkë me B58 edhe letrën standarde për tenderues të eliminuar si më poshtë:

Ndërsa AK në DT dhe NJK e ka vendosur kërkesën si më poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 9 . a) OE duhet të deklarojë se punëtorëve do t'u paguaj pagën minimale bruto 350 euro.

b) OE duhet të deklarojë se pagat e punëtorëve do të i paguaj për muajin paraprak, me se largu deri me datë 05 të muajit në vijim , pa marrë parasysh pagesën e bërë nga AK Dëshmia e kërkuar dokumentare Evidenca 9. a) Deklarata e nënshkruar dhe vëlosur nga OE se do të paguaj Pagat bruto 350 € si dhe do të respektoj dispozitat e Ligjit NR.08 L-257 për Administrimin e Procedurave tatimore si dhe Ligjit Nr.03 L-212 të Punës si dhe kërkesave të përcaktuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. b) Deklaratë me shkrim të nënshkruar dhe vëlosur nga OE Neve i kemi dorëzuar deklaratat e mësipërme dhe nuk kemi patur kurrfarë vërejtjeje nga ana e AK-së. Pra sipas kërkesës dhe dëshmive të kërkuara nga ana e AK-se askund nuk është kriter i vlerësimit Analiza financiare pra as që është përmendur fare analiza financiare në kërkesat e AK-se e lere ma se cilat informacione të përmbajë analiza financiare pra AK na ka eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit e as në njoftimin për kontratë që një eliminim i tillë është i kundërligjshëm dhe drejtpërsëdrejti bie ndesh me nenin 56.3 të LPP-se, për më tepër vet AK me datën 06.02.2025 ka publikuar Përgjigje në letrën standarde të kërkesës për informata shtesë si më poshtë:

siç shihet tek pyetja 4 dhe përgjigja e AK-se, vet AK kanë potencuar se Analiza financiare nuk do të jete kusht për kualifikim dhe përzgjedhje pra AK kanë vepruar me dy standarde në njërën anë vet e kanë dërguar me shkrim se Analiza financiare nuk do të jete kusht për kualifikim dhe përzgjedhje e në anën tjetër për këtë pikë na kanë eliminuar. Neve e kemi dorëzuar analizën financiare shumë të detajuar dhe nuk kemi lënë pikë pa e sqaruar ku në mënyrë të detajuar janë

dhënë shënimet për secilin lloj të orareve të punës pra edhe sikur AK ta kishte kriter të vlerësimit analizën financiare për këtë pike nuk ka mundësi që të na eliminoj, përderisa OE i shpallur fitues ka dhënë një analizë financiare të përgjithësuar. Neve i kemi plotësuar deklaratat sipas kërkesës 9 dhe i kemi ofruar dëshmitë sipas evidencës 9 të NJK dhe DT dhe AK nuk është dashur të na eliminoj për një kërkesë që nuk ka qene e vendosur në NJK dhe DT.

Me eliminimin tonë në këtë pikë AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së ku thuhet: “Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Për të faktuar se kemi interes juridiko material për këtë tender –Lot1, neve pajtohemi me eliminimin e OE me të lire se neve dhe për atë menjëherë neve e faktojmë se jemi OE me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin me të ulët. Tani po e faktojmë përgjegjshmërinë e OE të shpallur fitues për Lot 1 nga ana e AK-së: Neve kur in kemi shikuar dokumentet e OE fitues e kemi vërejt se licencat kanë qene të skaduar por pas qasjes në dokumente AK na ka ofruar licencat e OE fitues me afat ku bashkë me licenca kanë qene edhe vendimet ku shumë qarte në vendime shënon se OE fitues ka aplikuar për licencim me datën 20.02.2025 dhe 22.02.2025 dhe për të dy aplikimet është numër i protokollit 0009/2025 që neve dyshojmë se këto janë të manipuluar sepse sikur OE fitues ti kishte këto licenca në momentin të dorëzimit të ofertës do ti kishte bashkangjitur në Oferte. Ky është aplikimi i datës 20.02.2025 Dhe ky

Dhe ky është aplikimi i datës 22.02.2025.

Pra siç shihet me lartë data 22.02.2025 i bie dite e shtune dhe dihet botërisht se në vikend nuk punohet, pra MPB ka qene e mbyllur dhe ka qene dite vikendim

Pasi që konform udhëzimit administrativ kërkesa për vazhdimin e licencave i parashtrohet organit kompetent një muaj para datës së skadimit të licencës. Ndërsa sipas Ligjit LIGJI NR. 08/L-274 PËR SHËRBIMET PRIVATE TË SIGURISË nenit 10 pika 5 thuhet se : “Poseduesi i lejes duhet të aplikojë për vazhdim të lejes jo më herët se nëntëdhjetë (90) ditë para skadimit të afatit, dhe jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të afatit”.

Pra shihet qarte se këto licenca janë “kontrabanduar” pra licencat e mëhershme të këtij OE kanë skaduar me 20.11.2024 përkatësisht me 28.12.2024 gjë që është dashur të aplikoj me se voni me datën 20.10.2024 përkatësisht me 28.11.2024. shihet qarte se janë lëshuar kundërligjshëm licencat e reja, por brenga jone nuk është të mënyra e lëshimit sepse nuk është temë e jona kjo çështje për momentin, por brenga e jone është sepse në momentin e dorëzimit të tenderit këto licenca nuk kanë ekzistuar dhe këto licenca janë lëshuar pas dorëzimit të ofertave. Ndërsa tek AK këto Licenca janë dorëzuar me datën 30.04.2025. Neve do ti zbardhim dyshimet tona dhe këtë çështje do ti ndjekim deri në fund me organet kompetente. Neve me datën 26.05.2025 kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-se ku kemi besuar se AK do ti korrigjoj shkeljet dhe do ta kthej lenden në rivlerësim por AK vetëm copy-paste ku nuk ka marrë parasysh as deklaratat tona të dorëzuara as analizën financiare tonën të dorëzuar edhe pse nuk ka qene kriter i

vlerësimit ku neve e kemi dorëzuar analizën financiare me te kompletuar dhe ne përputhje te plote me Legjislacionin e Republikës se Kosovës ne Fuqi si me Ligjin e Punës ashtu edhe me ligjet tjera te tatimore. AK nuk e konteston faktin qe e kemi dorëzuar analizën financiare por sipas tyre nuk është ne përputhje te plote me DT dhe specifikat teknike te DT, e çka nuk është ne përputhje as AK nuk është ne dijeni. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Zyrtaret e AK me këtë vendim po tentojnë ta dëmtojnë neve dhe buxhetin e Komunës. Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Ndërsa në piken 2 thuhet :

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Gjithashtu AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së ku thuhet: “Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Gjithashtu AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 59.4 te LPP-së ku thuhet: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Tenderi i GOE nuk është ne përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit dhe kemi ofertuar me tenderin e përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Delta Security” SH.P.K.,konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së: Neni 1 Qëllimi., Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Neni 27 Dosja e Tenderit. Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe

Dhënien e Kontratave Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës. Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të KRPP-se. Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa që duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK-ne që ti respektoj në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këtë lloj të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr: V E N D I M të APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik : “Delta Security” SH.P.K. në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave me nr. të prokurimit: 616-24-10100-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. ANULOHET njoftimi B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave me nr. të prokurimit: 616-24-10100-2-1-1 dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: “Delta Security” SH.P.K., Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsye si në vijim:

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që as për vet parashtruesin nuk është kontestues fakti që në DT konkretisht në ST është kërkuar që të dorëzohet analiza financiare. Nuk është kontestues as fakti që parashtruesi e ka dorëzuar dokumentin e tillë mirëpo analiza financiare nuk i përfshin të dhënat e kërkuara me DT/ST dhe për këtë arsye është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se oferta e dorëzuar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT duke përfshirë edhe licensat dhe autorizimet e kërkuara.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 11.06.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë

shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0471/2025 dhe me datën 16.06.2025 ankesën me nr. 0484/2025,

Ndërsa me datë 25.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0471 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Ndërsa për ankesën 2025/0484 me datën 29.06.2025 rekomandimi si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës me nr.0471/25 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues pajtohet ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0484/25 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “SKYFTERAT – LIVE” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0471 ka vlerësuar si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e lëndës, konstatojmë si në vijimë:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1.

OE “Skifterat - Live sh.p.k.” shpk. Ferizaj pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 1 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese që të sigurojnë mënyrë më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, si dhe të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë

e zyrtarëve publik.

AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar , me arsyetimin e mos përputhjes së çmimit total dhe formularit të tenderit .

OE pretendon se gabimisht është eliminuar sepse ka ndodhur një gabim teknik dhe i njëjta gabim është Brenda normës së lejuar $\pm 2\%$.

Ekspertja është e mendimit se nuk qëndron pretendimi i OE ankues ma gjerësisht do ta gjeni përgjigjeje te pretendimi për shkeljen e nenit 59 të LPP-së i cili trajtohet sipas radhitjes se pretendimeve .

Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2.

OE "Skifterat - Live sh.p.k." shpk.Ferizaj pretendon se Kuvendi i Komones së Prishtinës nuk e ka respektuar qellimin e nenin 7 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Pretendimi i OE ankues: se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së

OE ankues nder tjera pretendon se AK ne kundërshtim me qëllimin e nenit 7 të LPP qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë ,duke larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjore të vendosura ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë .

Ekspertja sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues ,i njëjti pretendim është i pa bazuar sepse AK ka ndërmarr veprime për të kërkuar sqarime lidhur me pretendimet e OE ankues për çmimet dhe për ti kompletuar disa dokumente për OE e shpallur fitues dhe pas pranimit të informatave nga të dy ofertuesit , e ka eliminuar OE ankues, dhe e ka shpallur fituesin e këtij aktiviteti të prokurimit për të cilin ka konstatua se i ka plotësuar kriteret e parapara me NJK dhe DT.

Sa i përket pretendimit për ti larguar kërkesat kufizuese dhe jo ligjore të vendosura ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ,

Ekspertja sqaron se ky pretendim është jashtë afatit sepse në këtë fazë nuk mundë të kontestohen kriteret e vendosura në NJK dhe DT ,gjithashtu sqarohet se kriteret e parapara me NJK dhe DT mundë të kontestohen brenda afatit të paraparë për sqarimin e tenderit i cili afat përcaktohet me rastin e publikimit të aktivitetit të prokurimit me NJK dhe DT. Andaj ky pretendim në këtë fazë është i pa lejuar, sepse siç u sqarua ma lart është jashtë afatit të paraparë .

Andaj, Ekspertja sqaron se pretendimet janë të bazuara.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3 dhe 4.

OE "Skifterat - Live sh.p.k." shpk.Ferizaj pretendon se Kuvendi i Komones së Prishtinës nuk e ka respektuar qellimin e nenin 10 dhe 11 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i nenit 10 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë transparente ,pra AK në secilën fazë duhet ti përdor mjetet për promovimin e transparencës qe nënkupton edhe në fazën e qasjes ne dokumente publike ,si dhe ndër të tjera qellim i nenit 11 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet ti trajtojë informatat sekrete afariste .

OE ankues nder te tjera pretendon se për ofertën e OE fitues AK nuk ka dhënë qasje ne tërë ofertën-dokumentacionin i njëjti e specifikon se ne dokumentet qe OE i shpallur fitues te cilat i ka markuar si sekret afarist nuk na ishte ofruar qasja ne ato dokumente dhe i njëjti thekson se nuk është përgatitur versioni i pastruar nga ana e AK siç udhëzon rropi ne fuqi.

Ekspertja sqaron se disa dokumente janë te mbrojtura me ligj mirëpo është kusht qe për te njëjtat te plotësohet kërkesa për konfidencialitet e cila gjendet ne dosjen e tenderit ne aneksin 3 te DT ,gjithashtu ekspertja sqaron se OE i shpallur fitues e ka plotësuar këtë kusht sepse e ka plotësuar kërkesën për konfidencialitet, ndërsa për dokumentet e tjera edhe OE ankues nuk ka ndonjë pretendim sepse vet e thekson se dokumentet e tjera ka pasur qasje .

Andaj Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 5 dhe 6.

OE "Skifterat - Live sh.p.k." shpk.Ferizaj pretendon se Kuvendi i Komones së Prishtinës nuk e ka respektuar qellimin e nenin 59 të LPP-së,si dhe neni 40 të RRPP-së

Ekspertja thekson se qellim i nenit 59 te LPP-së dhe neni 40 të RRPP-së, është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahاسimi i tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit, i cili pasi i ka vlerësuar ofertat e pranuar ka dhënë rekomandim dhe i njëjti rekomandim është aprovuar nga udhëheqësi i prokurimit ,

Ekspertja sqaron se Autoriteti Kontraktues me rastin vlerësimit të ofertave, operatorin ekonomik ankues e ka trajtuar si Operator Ekonomik të eliminuar .

1.OE ankues nderë të tjera pretendon se është eliminuar per këtë kriter :

Pretendimi Vendimtar sa i perket trajtimit te OE ankues :

Kompania jonë sipas Njoftimit mbi vendimin e AK-së është eleminuar në arsyetim: Një mospërputhje është vënë re në çmimin e ofruar: në formularin e ofertës është paraqitur shuma

prej 1,248,712.98 EUR, ndërsa paramasa është dhënë një çmim tjetër prej 1,246,804.20 EUR, duke krijuar një diferencë prej 1,908.78 EUR. Komisioni ka kërkuar sqarim në lidhje me këtë mospërputhje dhe ka kërkuar informacion se cili është çmimi përfundimtar: ai i formularit apo ai i paramasës. Me datë 30.04.2025, janë pranuar sqarimet shitesë nga GOE, ku ata kanë konfirmuar se çmimi i paraqitur në formular është korrekt. Pas shqyrtimit të këtyre sqarimeve, komisioni konstaton se GOE nuk ka ofruar dëshmi bindëse që të justifikojnë këtë mospërputhje, e cila është në kundërshtim me nenin 40.10 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr.001/2022, i cili parashikon që në rast të mospërputhjes mes çmimit të formularit dhe përshkrimit të çmimeve, oferta refuzohet.

Arsyetimi i AK-së është i gabuar dhe nuk përkon me realitetin. Kompania jonë ka pranuar përmes platformës së E-prokurimit me datë 29.04.2025 letrën standarde për sqarimin e tenderit, dhe me datën 30.04.2025 kemi kthyer përgjigjen tonë Autoritetit Kontraktues poashtu përmes platformës së E-prokurimit duke ngarkuar dëshmitë e kërkuara.

Provë: Letra standarde për sqarimin e tenderit nga Autoriteti Kontraktues, datë 29.04.2025.

Provë: Përgjigje letrës standarde për sqarimin e tenderit nga Operatori ekonomik, datë 30.04.2025.

Në përgjigjen e dërguar sipas dokumentit të bashkangjitur, aty ku Autoriteti Kontraktues ka cekur në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar se "Me datë 30.04.2025, janë pranuar sqarimet shitesë nga GOE, ku ata kanë konfirmuar se çmimi i paraqitur në formular është korrekt." nuk është e vërtetë dhe është plotësisht e pasaktë, sepse ne kemi shënuar "Sa i përket mospërputhjes së çmimit në formularin e ofertës dhe çmimit të paramasës, ju informojmë se çmimi në paramasë është i saktë dhe se ka ndodhur ndonjë gabim teknik".

Pra ne kemi thënë se çmimi në paramasë është i saktë dhe se ka ndodhur ndonjë gabim teknik, dhe nuk kemi thënë se çmimi i paraqitur në formular është korrekt.

Ekspertja sqaron se sa i përket pyetje përgjigjejeve qendron pretnimi i OE ankues sepse i njeiti ka dorezuar letrën standarde për sqarime dhe ne letrën standarde ka dhënë sqarime siq i ka potencuar në ankesë, sepse ne kete leter sqaruese OE ankues ka sqarua se çmimi në paramasë është i saktë mirepo si baze për eliminim është marrë oika b. e paragrafit 40.10 të RRPP-ne fuqi.

Ndërsa sa i përket mospërputhjes në mes të çmimit të paramasës dhe çmimit të formularit të tenderit Ekspertja sqaron se kemi këtë gjendje :

Çmimi në procesverbalin e hapjes është: 1,248,712.98€

Çmimi në përshkrimin e çmimit është: 83,120.28 (kur kalkulohet me 15 muaj na jepet rezultat: 1,246,804.2€

Çmimi në formularin e tenderit është: 1,248,712.98€

Çmimi në analizën financiare është: 1,248,712.98€

Ekspertja sqaron se AK e ka eliminuar OE ankues për shkak të mospërputhjes së çmimit të dhënë në përshkrimin e çmimit dhe çmimit në formularin e tenderit dhe i njëjti AK për eliminimin e OE ankues bazohet në nenin 40.10 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr.001/2022, i cili parashikon që në rast të mospërputhjes mes çmimit të formularit dhe përshkrimit të çmimeve, oferta refuzohet.

OE ankues nuk pajtohet me këtë eliminim dhe thekson se kjo mos përputhje ka të bëjë me gabim teknik dhe i njëjti gabim hyn Brenda marzhës së lejuar $\pm 2\%$,

I njëjti thekson se : Dispozita ligjore e cekur nga ana e Autoritetit Kontraktues Neni 40.10 pika b. e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik nuk mund të përdoret si arsye për ofertën tonë për shkak se kompania jonë Çmimin njësi e ka në rregull dhe pikërisht vlen dispozita e njëjtë pika a) për rastin e ofertës sonë ku thuhet: "Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet".

Ekspertja sqaron se nga gjithsej 11 faqet e kësaj ankese sa i përket trajtimit të OE ankues dhe përcaktimit të statusit të OE ankues e që nënkupton edhe përcaktimin e fituesit të këtij Loti vijmë në përfundim se kontestuese në këtë rast janë pika a. dhe pika b. e nenit-paragrafit 40.10 të RRPP nr.001/2022 për prokurim publik (versioni i konsoliduar),e që nënkupton se rasti , a i përket pikës a. apo pikës b. e nga ky këndvështrim varet edhe trajtimi i ofertës së OE ankues dhe të kësaj ankese sepse nuk është kontestuese se gabim hyn Brenda marzhës së lejuar $\pm 2\%$, por kontestuese është vetëm trajtimi i rastit me piken a. apo piken b.

Shihë piken a .dhe piken b. të paragrafit 40.10 :

a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;

b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Ekspertja fillimisht sqaron se OE ankues ka ofertuar me një ofertë financiare me çmim më të lirë se sa OE fitueses me diferencë/ndryshim sikurse u theksua në ankesë,ndërsa i njëjti është eliminuar vetëm për një arsye siq është mospërputhja e çmimit të paramasës me çmimin e dhënë në formularin e tenderit dhe AK bazuar në paragrafin 40.10 piken b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet, e ka eliminuar OE ankues .

Ekspertja sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues i cili pretendon se ky rast duhet të trajtohet me piken a. e cila pikë na udhëzon se, Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet.

Tani në rasti konkret meqë kemi te bejm me: mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve dhe totalit te analizes financiare nuk mundë të trajtohet rasti sipas pikes a.te paragrafit 40.10 siq pretendon OE ankues,sepse kjo pikë flet per rastet kur: ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet ,e ne rastin konkret kemi te bejm me mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve dhe analizes financiare e qe mendojë se ky rast rregullohet me piken b. e cila e percakton ne këtë menyre :

b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Pasi që pika b. na udhëzon per rastet kur ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve që oferta të refuzohet, mendoj se nuk kemi bazë ligjore per aprovimin e kësaj ankese .

Andaj, Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë

OE ankues nder te tjera pretendon se , Në dosjen e tenderit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1&7.2

Kërkesa 5. Opertarori Ekonomik duhet të posedoj Frekuencat për sistem radio komunikimi, lëshuar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) (valide)

Evidenca 5. Të dëshmohet me licencë nga ARKEP (kopje e noterizuar). Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "Autorizimin Individual" me nr.23/02/0137 me periudhë të vlefshmërisë deri me datën 22.02.2025 që i bie se është e skaduar, pasi që data e dorëzimit të ofertave ka qenë 24.02.2025.

Ekspertja sqaron se me vemendje e ka analizuar këtë pretendim dhe ka analizuar Licencen e dorezuar nga ofertuesi dhe e njejta me rastin e ofertimit është dorezuar ashtu siq pretendon OE ankues ,mirëpo AK me datë 29.04.2025 permes letres standarde te ngarkuar ne platformen e e-prokurimit ka kerkua sqarime dhe OE i rekomanduar per kontratë me date 30.04.2025 ka dhenë sqarime duke dorezuar te njejtat me valeditet deri me daten 24.02.20230 .

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë.

Pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë

OE ankues nder te tjera pretendon se , Operatori ekonomik dokumentin e ngarkuar "Lista e Çmimit" ka ndryshuar dhe ndërhyrë duke ngjyrosur disa kolona me ngjyrë pembe, gjë që nuk është e lejuar të modifikohet sepse ligji ka ndaluar ndryshimin apo modifikimin e përmbajtjes.

Ekspertja sqaron se e ka analizuar këtë pretendim dhe e ka shiquar përshkrimin e çmimit dhe ofertën e dorëzuar nga OE fitues dhe nuk ka vërejtur asnjë ndryshim madje as ne ngjyrosjen e përshkrimit ,sepse me ngjyre pembe i njëjti përshkrim është ne platformën e e prokurimit te hartuar nga AK dhe nuk ka ndonjë ndryshim as ne përmbajtje sa ne ngjyrë.

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë.

Pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë

OE ankues nder te tjera pretendon se , Poashtu në dosjen e tenderit është kërkuar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 3. d) Licenca dhe Autorizimi për një klient aktiv për Shërbimet e Tubimeve Publike sipas Ligjit Nr.04 L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë (valide)

Evidenca 3. d) Të dëshmohet me licencë dhe autorizim nga MPB (valide) (kopje); Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "Autorizim për fillimin e veprimtarisë" me nr.prot.2834 të datës 26.12.2024 e cila tek pjesa e Arsyetimit tregon se fillimi dhe ndërprerja e kontratës me klientin është e skaduar pra deri më 28.12.2024. Sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Autorizim valid për një klient aktiv!

Ekspertja sqaron se me vëmendje e ka analizuar këtë pretendim dhe ka analizuar Licencën e dorëzuar nga ofertuesi dhe e njëjta me rastin e ofertimit është dorëzuar ashtu siç pretendon OE ankues ,mirëpo AK me datë 29.04.2025 përmes letrës standarde te ngarkuar ne platformën e e-prokurimit ka kërkuar sqarime dhe OE i rekomanduar për kontratë me date 30.04.2025 ka dhënë sqarime duke dorëzuar te njëjtat me valeditet deri me datën 24.02.20230 .

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë.

Pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë

OE ankues nder te tjera pretendon se , Poashtu në dosjen e tenderit është kërkuar: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të caktoj a)- minimum (1) menaxher të projektit me vendim i cili ka përvojë pune min.3 vite dhe është i certifikuar për menaxhim risku dhe I licencuar nga MPB si menaxher i sigurimit zyrtar në detyrë si për shërbimet themelore dhe të specializuara.

Evidenca 4. a). Dëshmi që Menaxheri i Projektit duhet të ketë të kryer shkollimin e mesëm, të dëshmohet me kopje të diplomës, b. Duhet të dëshmoj se ka përvojë 5 vjeçare në lëmin e sigurimit fizik, c. Duhet të dëshmoj me Licencën për Menaxher nga MPB-me në fushën e sigurisë fizike sipas Ligjit Nr.04 L-004 për Shërbimet Private të sigurisë. Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar dokumentet e menaxherit

me emër KRESHNIK IMERAJ" i njëjti është I licencuar vetëm si Menaxher për shërbimet themelore të sigurisë, dhe jo për ato të specializuara

Ekspertja sqaron se e ka analizuar këtë pretendim dhe sqaron se edhe për këtë janë kërkuar informacion shtese me date 29.04.2025 dhe ka pranuar përgjigjeje me date 30.04.2025 përmes platformës së e-prokurimit dhe ka analizuar Licencën e dorëzuar nga ofertuesi për z. Kreshnik Imeraj në këtë licencë shkruan „Punëtor i specializuar i sigurimit –Menaxher për shërbimet themelore të sigurimit e që mendoj se e ka plotësuar kriterin e parapare .

Andaj Ekspertja mendon se ky pretendim është i pa bazuarë.

Pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë

OE ankues ndër të tjera pretendon se Poashtu në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë është kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses, kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Për lotin 1, OE duhet të këtë kontrata të përfunduara jo më pak se 1,995,000.00 euro,

Evidenca 1. Lista e kontratave të përfunduara në lëmin e shërbimeve të ngjashme, për tri vitet e fundit, e cila duhet të jete nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke Saktësuar; Titujt e kontratës, shumën e kontratës, datën e nënshkrimit dhe datën e përfundimit – Lista duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, dhe të i bashkangjes dëshmitë e përfundimit , Referenca , ose procesverbalet e pranimit, kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve, mund të shërbejnë edhe dëshmi tjera të pranimit të shërbimeve, të cilat duhet të dëshmojnë me transaksione bankare të plotësohet Aneksi 7 – obligueshme për dy Lotet.

Operatori i rekomanduar për kontratë për LOT-1 ka dorëzuar dëshminë e kërkuar "Transaksionet bankare" mirëpo të njëjtat janë të vulosura nga vetë operatori ekonomik dhe jo nga banka, gjë që nuk mund të vërtetohet saktësia e këtyre transaksioneve bankare për shkak se të njëjtat nuk janë të validituara nga bankat komerciale të licencuara nga BQK.

Ekspertja sqaron se me vëmendje e ka analizuar këtë pretendim dhe ka analizuar kriterin dhe dokumentet e dorëzuar nga ofertuesi dhe sqaron se AK me datë 29.04.2025 përmes letrës standarde të ngarkuar në platformën e e-prokurimit ka kërkuar sqarime dhe me date 30.04.2025 OE i rekomanduar ka dhënë sqarime duke dorëzuar referencat dhe dëshmi të tjera por me një kalkulim vetëm nga shuma e referencave të dorëzuara plotësohet kriteri i parapare me NJK dhe DT sepse vetëm referencat e tejkalojnë shumën e kërkuarë pa i kalkuluar edhe fakturat për të cilat pretendon OE ankues se nuk janë të vulosura nga banka .

Andaj Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 7 dhe 8.

OE "Skifterat - Live sh.p.k." shpk.Ferizaj pretendon se Kuvendi i Komones së Prishtinës nuk e ka respektuar qellimin e nenin 60 të LPP-së,si dhe neni 27 të RRPP-së

Ekspertja thekson se qellim i ketyre dy dispozitave është vendosja e kriterit per dhenje të kontrates,ku kriter ishte tenderi i pergjegjeshëm me çmim më te ulët .

OE ankues ndër te tjera pretendon se me rastin eliminimit te ofertes tonë AK ka shkelur nenin 60 te LPP-së dhe nenin 27 te RRPP-së sepse i kemi plotesuar te gjitha kritret e prapara me NJK dhe DT dhe kemi ofertua me çmim ma te lire .

Ekspertja sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues pasi qe ky pretendim nderlidhet edhe me pretendimet e tjera dhe pasi që të njejtat ishin të pa bazuara,edhe ky pretendim nuk qendron dhe është i pa bazuar sepse OE ankue ka dhenë teter çmim ne paramas dhe tjetër çmim ne formularin e tenderit dhe ma gjeresisht u dha pergjigjeje ne pretendimin paraprak.

Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Lidhur me pretendimet e OE "Delta Security" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0484 ka vlerësuar si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e lëndës, konstatojmë si në vijimi:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1.

OE "Delta security sh.p.k." shpk.Prishtinë pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 1 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër tjera qellim i këtij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë mënyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, si dhe të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik.

AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar , me arsyetimin e se analiza financiare nuk përmban informacione te mjaftueshme që te justifikojë çmimin e paraqitur, sipas aneksit 1 te specifikimit teknik te detyrueshëm ,ku AK thekson se ne analizen financiare nuk janë paraqitur :pagat bruto për puntor me te gjitha kontributet dhe tatimet ,

Uniformat verore dhe dimërore sipas specifikacionit ne DT dhe shpenzimet e tjera ,fitimin e parapare ,çmimi total I tenderit duhet te llogaritet dhe inkorporohet në çmimin e oreve në tabelen e specifikimit te çmimit ,Komisioni pas shqyrtimit te plotë te ofertës konstaton se ajo është e pa përgjegjshme ,pasi nuk ka dëshmuar dëshmi bindëse mbi arsyetimin e çmimit .

OE ankues nder tjera pretendon se gabimisht është eliminuar dhe kjo bi ne kundërshtim me qëllimin e nenit 1 të LPP-së si dhe i njëjta pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT ma gjerësisht siç ka potencuar ne ankesë .

Ekspertja sqaron dhe është e mendimit se nuk qëndron pretendimi i OE ankues ma gjerësisht do ta gjeni përgjigjeje te pretendimi për shkeljen e nenit 59 te LPP-së i cili trajtohet sipas radhitjes se pretendimeve .

Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2.

OE “Delta security sh.p.k.” ShPK. Prishtine pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 6 të LPP-së .

Ekspertja sqaron se nderë të tjera qëllimi i nenit 6 të LPP-së është të udhëzohen autoritetet kontraktuese të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

AK e ka trajtuar OE ankues si të si të eliminuar duke trajtuar se oferta e dorëzuar nuk ishte në harmoni me te gjitha kriteret e parapara me Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit lidhur me te vetmen pikë kontestuese ,siç u përmend ma lart për analizën financiare .

OE ankues nder tjera pretendon se gabimisht është eliminuar dhe kjo bi ne kundërshtim me qëllimin e nenit 6 të LPP-së si dhe i njëjti pretendon se OE i shpallur fitues nuk i ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT ma gjerësisht siç ka potencuar ne ankesë do ti trajtojmë ne pretendimet për shkeljen e nenit 59 te LPP-së .

Ekspertja sqaron dhe është e mendimit se nuk qëndron pretendimi i OE ankues ma gjerësisht do ta gjeni përgjigjeje te pretendimi per shkeljen e nenit 59 te LPP-së i cili trajtohet sipas radhitjes se pretendimeve .

Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3. OE “Delta security sh.p.k.” shpk. Prishtinë pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 7 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Pretendimi i OE ankues: se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së

OE ankues nder tjera pretendon se AK ne kundërshtim me qëllimin e nenit 7 te LPP-së e ka eliminuar ofertën tonë dhe njëkohësisht pretendon se e ka favorizuar OE e shpallur fitues pa i plotësuar te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT.

Ekspertja sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues ,i njëjti pretendim është i pa bazuar sepse gjate ekzaminimit te lendes përkatësisht gjat procesit te vlerësimit nuk kam vërejtur se ka pasur diskriminim apo favorizim te ndonjë ofertuesi.

Andaj, Ekspertja sqaron se pretendimi është i pa bazuara.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4,5 dhe 6

OE "Delta security sh.p.k." shpk. Prishtinë pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk e ka respektuar nenin 27 ,56 dhe neni 59 të LPP-së .

Ekspertja sqaron se ndër të tjera qellim i neni 27 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve.

Gjithashtu Ekspertja sqaron se ndër të tjera qellim i neni 56 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të trajtohen ofertat me dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen dhe dhënien e kontratës ,ku se pari behet vlerësimi te tenderëve dhe kandidateve sipas kërkesave te kualifikimit te specifikuar ne NJK dhe DT ,sipas paragrafit 2 te nenit 51 te këtij ligji dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike te kërkuara ne bazë te nenit 28 të LPP-së ,se dyti ne baze te kriterëve te vendosura ne nenin 60 te LPP-së .

Ekspertja thekson se qellim i nenit 59 te LPP-së dhe dispozitat perkatese të KRPP-së,është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit,i cili pasi i ka vlerësuarë ofertat e pranuar ka dhënë rekomandim dhe i njëjti rekomandim është aprovuar nga udhëheqesi i prokurimit ,

Kronologjia:

Ekspertja sqaron se OE ankues ishte eliminuar,me arsyetimin se analiza financiare nuk përmban informacione te mjaftueshme që te justifikojë çmimin e paraqitur, sipas aneksit 1 te specifikimit teknik te detyrueshëm ,ku AK thekson se ne analizën financiare nuk janë paraqitur :pagat bruto për punëtor me te gjitha kontributet dhe tatimet ,

Uniformat verore dhe dimërore sipas specifikacionit ne DT dhe shpenzimet e tjera ,fitimin e parapare ,çmimi total i tenderit duhet te llogaritet dhe inkorporohet në çmimin e orëve në tabelën e specifikimit te çmimit ,Komisioni pas shqyrtimit te plotë te ofertës konstaton se ajo është e pa përgjegjshme ,pasi nuk ka dëshmuar dëshmi bindëse mbi arsyetimin e çmimit .

OE ankues nder te tjera pretendon se sipas përgjigjeje-sqarimeve me letrën standarde te cilën e Autoriteti Kontraktues e ka ngarkuar në platformën e e prokurimit me date 06.02.2025 vet AK e ka potencuar se Analiza financiare nuk do te jetë kusht për kualifikim dhe përzgjedhjen ,pra AK ka veprua me dy standard ne njërën ane vete e ka dërgua me shkrim se analiza financiare nuk do jetë kusht për kualifikim dhe përzgjedhje ndërsa ne anën tjetër për këtë pik na ka eliminuar .

Gjithashtu i njëjta shton se ne kemi dorëzua analizën financiare shume te detajuar dhe për këtë pikë nuk ka mundësi qe te na eliminoje .

Ekspertja sqaron se përgjigjja e datës 06.02.2025 është sikurse ka theksua OE ankues dhe e njëjta lenë hapësirë qe te interpretohet ne dy mënyra ,dhe e njëjta nuk është profesionale ne formën siç është dhënë nga ana e autoritetit kontraktues ,sepse siç pretendon OE ankues shihet se ka ra ne lajthim me këtë përgjigjeje .

Gjithashtu Ekspertja sqaron se analiza financiare nuk ishte eliminuar(hekur) nga DT për këtë aktivitet te prokurimit siç pretendon OE ankues sepse për tu eliminuar(hekur) AK do duhej të te përgatitet formularin B54 Njoftimin për informata shtesë ose përmasimin e gabimit ,si dhe do duhej te korrigjonte dosjen e tenderit versionin e fundit ne te cilën do duhej te identifikohen ndryshimet konform korrigjimeve te bëra në formular siç na udhëzon paragrafi 24.7 i nenit 24 të RRPP-së ne fuqi (version i konsoliduar),e kjo nuk kishte ndodhur as me formular as me dosjen e tenderit .

Pra dosja e tenderit sa i përket kësaj pike ka mbetur e njëjte për ta pasur edhe ma te qartë se si kriteri i parapare me dosjen e tenderit i obligon ofertuesit qe te dorëzojnë analizën financiare po e vendosi kriterin dhe aty shihet se kriteri obligon qe te respektohet aneksi 1i specifikave teknike ndërsa ne ansin 1 te DT është e parapare analiza financiare shih kriterin dhe aneksin 1 te DT:

Shih se si ndërlihet kriteri me aneksin 1 te DT ku përfshihet edhe analiza financiare.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave -Ri-tender

Duke marr parasysh rendësin e objekteve qe duhet te ruhen si dhe nivelin stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçante për AK. Paga minimale Bruto bazë (pa aplikimin e tatimeve, kontributeve dhe lejimeve konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ne fuqi), për roje fizike të angazhuar ne këtë kontratë duhet të jetë jo me pak se 350 €/muaj brutto, kurse për Zv.menaxherin 443 € bruto dhe për Menaxherin e rojeve 500 euro bruto. Ky çmim është për ndërrimin e parë(orët e ditës). Kontraktori është i obliguar qe respektoj Ligjin e

punës, Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr. 09/2013 dhe të paguaj shtese mbi pagën Bruto bazë për ndërrimin e dytë dhe të tretë dhe festa, shujtën dhe sigurimin shëndetësor. 2. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet të përfshijë se paku:

- Pagat Bruto për punëtorë me të gjitha kontributet dhe tatimet,
- Pushimet vjetore, ndërrimet e natës, festat shtetërore.
- Shpenzimet operative, përfshirë vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit në dosje të tenderit dhe shpenzimet tjera, fitimin e paraparë,
- Çmimi i total i tenderit duhet të llogaritet dhe inkorporohet në çmimin e orëve në tabelën e specifikimit të çmimit.

Ekspertja thekson se me qëllim të sqarimit sa ma të detajuar ma lart vendosa pretendimin ,kriterin e paraparë me DT ,nderlidhjen e kriterit me specifika teknike dhe mbi arsye theksuara ma lart sqaroj se nuk është i pranueshëm pretendimi i OE ankues sepse siq u sqarua ma lart OE ankues në këtë fazë nuk mundë ta kontestoj kriterin e paraparë me NJK dhe DT perderisa ,siq ishte analiza financiare nuk janë nderrmarr veprime siq parashihen me nenin 24.7 të nenit 24 të RRPP-së dhe sqarimit që u dha ma lart .

Gjithashtu Ekspertja mendon se në analizen financiare të dorëzuar nga OE ankues nuk janë përfshirë të gjitha siq janë kërkuar me specifika teknike ,në tërë analizen financiare nuk janë përfshirë uniformat e të cilat ishin parapare me specifika teknike andaj edhe sa i përket pretendimit të OE ankues se ka dorëzuar analizen financiare siq ishte kërkuar nuk qëndron .

Sa i përket pretendimit se është eliminuar në mënyrë të kundershtueshme ky pretendim nuk qëndron ,ndersa sa i përket pretendimit se sqarimet e dhëna nga ana e AK me datë 06.02.2025 kanë krijuar kuptim të dyanshëm i njëjta pretendim qëndron ,mirëpo në këtë fazë nuk ka ndonjë rolë në përcaktimin e pranueshmërisë apo hedhjes së ankesës sepse ky pretendim do duhej të bëhet në fazën para hapjes së tenderëve ,meqë nuk është kontestuar atë kohë tani kriteri mendoj se ka formën e prerë e që nënkupton se është i pa ndryshueshëm dhe duhet të respektohet siq është paraparë me NJK dhe DT.

Andaj, Ekspertja sqaron se pretendimi është pjesërisht i bazuar por pa efekt për kthimin e lëndës në rivlerësim.

Pretendimi ndaj OE të rekomanduar për kontratë

OE ankues ndër të tjera pretendon se , kur i kemi shikuar dokumentet e OE fitues kemi vërejtur se Licencat janë pa afat ,por pas qasjes në dokumente AK na ka ofruar licencat e OE fitues me afat ku bashkë me licencat kanë qenë edhe vendimet ku qart shkruan se OE fitues ka aplikuar për licencë me datë 20.02.2025 dhe 22.02.2025 dhe për të dy aplikimet është numri i protokollit 0009/2025 e që në dyshojmë se këto janë manipuluar sepse sikur OE ti kishte këto oferta do ti

kishte bashkangjitur me ofertë ,i njeiti pretendon se ne nje forme keto licenca jane kontrabanduara .

Ekspertja sqaron se me vemendje e ka analizuar këtë pretendim dhe këtë supozim te OE ankues por e njeita sqaron se AK ka konstatua se jane plotesuar te gjitha keto kritere dhe per te njejtat edhe OE ankues nuk e konteston permbajtjen por i njeiti siq u theksua ma lart e konteston menyren e nxirrjes se tyre ,nuk kam qka te shtojë vetem e sqarova kronologjin e ketij pretendimi e sa i perket konstatimit sqaroj ky pretendim nuk hyn në kompetencat e Ekspertit shqyrtues andaj edhe nuk leshohet fare ne shqyrtimin etij

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa lejuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 7

OE "Delta security sh.p.k." shpk. Prishtinë pretendon se Kuvendi i Komunës së Prishtinës nuk e ka respektuar qellimin e nenin 60 të LPP-së

Ekspertja thekson se qellim i kesaj dispozite është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si të bëhet vendosja e kritert per dhenje të kontrates,ku kriter ishte tenderi i pergjegjëshëm me çmim më te ulët .

OE ankues ndër te tjera pretendon se me rastin eliminimit te ofertës tonë AK ka shkelur nenin 60 te LPP-së sepse i kemi plotësuar te gjitha kriteret e prapara me NJK dhe DT dhe kemi ofertua me çmim ma te lire .

Ekspertja sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues pasi qe ky pretendim nderlidhet edhe me pretendimet e tjera dhe pasi që të njejtat ishin të pa bazuara,edhe ky pretendim nuk qendron dhe është i pa bazuar ,ndersa ma gjeresisht u dha pergjigjeje ne pretendimin paraprak.

Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga

rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me ankesën nr: 484/2025; Refuzohet si e pabazuar ankesa per Lot-1, aktivitetin e prokurimit, sipas raportit me rekomandim te ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesë 471/2025; Aprovohet si e bazuar ankesa dhe aktiviteti i prokurimit per LOT-1 kthehet ne Rivlersim ngase Operatorit ekonomik nuk i është lejuar qasja ne dokumnetet e aktivitetit te prokurimit , qasja ka qene e kufizuar në dokumentet e këtij aktiviteti të prokurimit pasi që Autoriteti Kontraktues dokumentet e klasifikuara si sekret afarist, te evitentura nga operatori i rekomanduar për kontratë nuk i ka lejuar qasje dhe nuk e ka përgatit versionin e pastruar të dokumenteve të klasifikuara si sekret afarist,dhe me ket raste jane shkelur dispozitat ligjore Neni 7.6.3 të Rregullores Nr.002/2024 dhe Neni 11 par.4 të LPP-së. Neni 7.6.3 i Rregullores Nr.002-2024 thotë: Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE si parashihet me nenin 4 LPP-se, pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK B58, ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët. Lidhur me pretendimin e OE ankues se gabimisht është eliminuar sepse ka ndodhur një gabim teknik dhe i njëjta gabim është Brenda normes së lejuar $\pm 2\%$, gabimi eshte ne suaza ligjore armetike 2%, dhe se në keto raste kur kemi gabime artimetike ne 2% e ka rregulluar Rregullorja e KRPP-se 02/2024, neni 40.9 sipas te cilit “ *Komisioni vlerësues do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.*” Po ashtu Rregullorja KRPP-se neni 40.10 pika a ka percaktuar” Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet” Po ashtu konstaton se procedurat e sqarimit te AK dhe OE lidhur me këtë qështje kontestuese ka dhene sqarimet e mjaftushme AK. Autoriteti Kontraktues nuk e ka përfillur Nenin 1 dhe 6 të LPP-së, kursimin e buxhetit të Republikës së Kosovës, pasi OE i rekomanduar ka ofertën e me te shtrejte se sa ankuesi në shumë prej 4,780.08 euro, në muaj apo 71,701.20-euro për 15 muaj. Andaj nuk ja fale besimin e raportit me rekomandim te ekspertit shqyrtues, pasi ai e ka konstatuar gjendjen faktike dhe ate ligjore por ka nxjerr konstatime qe nuk përkojnë me gjendjen e vërtetur. Ngase vetë AK në letrën standarde për sqarime dërguar OE ankues me dt. 29.04.2025 ka pranuar që këtu ka të bëjë me gabime teknike dhe e cila është brenda kufijëve të 2% dhe kanë kërkuar sqarime, me çrast edhe OE ankues ju është përgjigjur se çmimi përfundimtar është ai i paramasës. Pra, kemi të bëjmë me një veprim të kundërligjshëm nga ana e AK. Dhe kjo është arsyeja që kjo ankesë e cila i përket LOT 1 duhet të kualifikohet si e bazuar dhe LOT 1 të kthehet në ri-vlerësim.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur të anuloj B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KK PRISHTINË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me nr. të prokurimit: 616-24-10100-2-1-1. Ndërkaq Lënda kthehet në Rivlerësim sipas gjetjeve në vendim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " SKYFTERAT - LIVE " SH.P.K., Delta Security SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: